




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština-Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 19 paragrafi 3 pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), konform nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2025 merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim znj. Flutra Durguti nga Rahoveci **I JEPET** në shfrytëzim afatgjatë deri **50 (pesëdhjetë) vite** prona e paluajtshme e komunës me certifikatë të pronësisë Nr. P-71510057-02240-76 në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur shume-kabilja glava, me kulturë mal i klasës 5, në sipërfaqe të përgjithshme prej 25000m² (njëzet e pesë mijë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në emër të Komuna e Rahovecit;
2. Prona e paluajtshme e cekur në pikën 1 të këtij vendimi jepen për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit sipas rekomandimit të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës me Nr. Prot. 1778 të datës 19.05.2025.
3. Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës fillon të rrjedh nga data 01.06.2025 dhe përfundon me datën 01.06.2075, ndërsa pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës, e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Rahovecit si titullar faktik dhe juridik i pronës.
4. Çmimi i dhënies në shfrytëzim i pronës të paluajtshme të lartëcekur do të jetë 625€ (gjashtëqind e njëzet e pesë euro) në muaj. Realizimi i pagesës së qirasë do të fillojë pas 24 (njëzet e katër) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, siç është cekur në vendimin për dhënien e pëlqimit paraprak me Nr. Prot. 01 Nr. 280/24 i datës 26.12.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin 01 Nr. 18/25 i datës 28.02.2025.
5. Obligohet kryetari i Komunës që me personin fizik dhe juridik përfitues të pronës së paluajtshme të komunës, të lidh kontratë me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
6. Obligohet shfrytëzuesi i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, që pronën e paluajtshme të cekur në nenin 1 të këtij vendimi ta shfrytëzoj me mirëbesim si nikoçir i mire, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

7. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë prone.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.60/25
Me datë:30.05.2025

